



Pranuar / Dorezuar Dimitur / Pristatë Received / Delivered		14.06.2021	viti god year
Organ / Njesia Organi / Jedinica Org. Unit	Id. Prist / Id. Prist / Prot. No.	Shtojca Pajlog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKNMBKUK	3069/2021		119



Republika e Kosovës Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

Anr.414/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për shqyrtimin e ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari-kryetare, Jeton Koca dhe Eshref Shabani-anëtarë dhe Zyle Millaku Gojnovci-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, sipas Aktgjykim A.nr.2773/19 të datës 29.04.2021 të Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, kanë shqyrtuar ankesën me numër Anr.536/2019 të datës 12.09.2019 të parashtruar nga ankuesi me adresë në Administratën Tatimore të Kosovës afër KEDS-it në Prishtinë, kundër organit të punësimit Administratës Tatimore të Kosovës, për çështjen juridike "kompensim material", duke vepruar në pajtim me nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 14.06.2021, mori këtë

V E N D I M

I. REFUZOHET si e pa bazuar ankesa e ankuesit me numër Anr.536/2019 e datës 12.09.2019.

II. SHFUQIZOHET Vendimi me numër protokollit 173 i datës 14.08.2019 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Administratës Tatimore të Kosovës.

A r s y e t i m

Ankuesi është i punësuar sipas Akt emërimit të datës 03.10.2018 në Administratën Tatimore të Kosovës në pozitën "Analist i Sistemit", në Departamentin e Teknologjisë Informatike, i cili me datë 15.07.2019 ka parashtruar ankesën me numër protokollit 11-06-2901 në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Administratës Tatimore të Kosovës me pretendim ankimor për aprovim e shtesës në pagë në vlerë prej 400 euro sipas Vendimit me numër 02/39 të datës 08.10.2008 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, mbi aprovimin e pagës shtesë për kategorinë e veçanta të stafit të Teknologjisë Informative.

Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave i Administratës Tatimore të Kosovës me datë 14.08.2019 nxjerr vendimin me numër të protokollit 173 me të cilin vendim aprovohet si e bazuar ankesa e ankuesit me numër 11-06-2901 e datës 15.07.2019 e parashtruar nga ankuesi dhe obligohet Divizioni i Burimeve Njerëzore dhe struktura tjera përgjegjëse

brenda Administratës Tatimore të Kosovës që në afat sa më të shkurtë të ndërmarrin të gjitha veprimet konkrete për rregullimin e shumës së shtesës konform pozitës aktuale të punës në përputhje me Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr.02/39 të datës 08.10.2008.

I pakënaqur me mos zbatimin e Vendimin me numër protokollit 173 të datës 14.08.2019 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave nga organi i punësimi, me datë 12.09.2019 parashtron ankesën me numër të protokollit 4282/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendime ankimore që ti bëhet kompensimi i mjeteve financiare, retroaktiv nga muaji dhjetor 2018 deri tani sipas Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës me numër 02/39 të datës 08.10.2018.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 19.09.2019 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Administrata Tatimore e Kosovës, ndërsa më datë 16.10.2019, Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë nga Administrata Tatimore e Kosovës me shkresat e bashkangjitura të lëndës 1/29.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nga muaji janar të vitit 2019 deri më datë 08.10.2020 ka qenë jo funksional dhe nuk ka vendosur për ankesën e ankuesit, ndërsa më datë 17.06.2019, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ka njoftuar ankuesen për arsyet e mos shqyrtimit të ankesës duke udhëzuar që mund të ndiqni procedurat e mëtejme dhe se në pajtim me Ligjin për Konfliktin Administrativ mund të filloni procedurën gjyqësore pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative.

Ankuesi ka ndjekur procedurat e tjera duke iniciuar konflikt administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative. Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, më datë 29.04.2021 ka nxjerr Aktgjykim A.nr.2773/19 me të cilin ka aprovuar kërkesëpadinë e paditëses duke anuluar njoftimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, të datës 17.10.2019 dhe duke e detyruar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës që brenda 30 ditësh të vendos për ankesën e datës 12.09.2019.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka administruar këto prova: Aktgjykim A.nr.2773/19 të datës 29.04.2021 të Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, Ankesën me numër Anr.536/2019 protokollit 4282/2019 të datës 12.09.2019 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Akt emërimi i datës 03.10.2018; Vendim i datës 28.09.2018; Vendimi i datës 24.10.2008; Shkresë-Aprovimi i datës 05.12.2008 e Administratës Tatimore të Kosovës; Vendimi i datës 08.10.2008 i Qeverisë së Kosovës Nr.02/39, Aneksi I; E-mail i datës 05.06.2019; E-mail i datës 04.02.2019 Vendimi i datës 14.08.2019 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave; Kërkesë e datës 15.07.2019; Përgjigje e datës 16.10.2019; Ndryshimi dhe kompensimi për muajin tetor 2018; Kërkesë për pagesë retroaktive e datës 05.12.2018 për barazim për muajin tetor dhe dhjetor 2018; Ndryshimi dhe kompensimi për muajin shkurt 2018; E-mail i datës 18.07.2019.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pas shqyrtimit të të gjithave shkresave të bashkëngjitura në lëndë, konstatoi se ankesa e ankuesit *është e pabazuar, sepse;*

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në bazë të provave të lëndës ka konstatuar që ankuesi *sipas akt emërimit të datës 03.10.2018 është i sistemuar në vendin e*

punës "Analist i Sistemit" në Divizioni i Zhvillimit të Aplikacioneve në Departamentin e Teknologjisë Informative. Ankuesi më datë 15.07.2019 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 11-02-2901 në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Administratën Tatimore të Kosovës për njohjen e të drejtës për kompensimin e shtesës në vlerë prej 400 euro në muaj, sipas Vendimit Nr.02/39 të datës 08.10.2008 të Qeverisë së Republikës së Kosovës si dhe ka kërkuar kompensimin në mënyrë retroaktive.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, duke u bazuar në dëshmitë e ofruara nga ankuesi dhe Organi i punësimit, ka konstatuar që ankuesi sipas akt emërimit të datës 03.10.2018 është i sistemuar në vendin e punës "Analist i Sistemit" në Divizioni i Zhvillimit të Aplikacioneve në Departamentin e Teknologjisë Informative, ndërsa me datë 15.07.2019 ka parashtruar ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Administratën Tatimore të Kosovës, jashtë afatit të përcaktuar ligjor prej 30 (tridhjetë) ditësh për parashtrimin e ankesave, respektivisht ankesa është parashtruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 8 paragrafit 2 të Rregullores Nr.05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe Ankesave, ku është përcaktuar se: *"Ankesa duhet të paraqitet brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga momenti kur nëpunësi civil konsideron se i janë shkelur të drejtat e tij nga marrëdhënia e punës"*, sepse ne rastin konkret momenti kur ankuesit i ka filluar ti rrjedhë afati ligjor për ankimim është atëherë kur ankuesi në xhirollogarinë e tij nuk e ka pranuar shtesën në vlerë prej 400 eurove sipas Vendimit Nr.02/39 të datës 08.10.2008 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, gjegjësisht nga data 03.11.2018 .

Andaj Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar se me datë 14.08.2019 Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave në Administratën Tatimore të Kosovës, me rastin e nxjerrjes së Vendimit me numër protokolli 173, ka vepruar në kundërshtim me Ligjin Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, me Ligjin Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Rregullores Nr.05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe Ankesave, sepse nuk ka arritur që ta vërtetoj drejtë gjendjen faktike dhe juridike lidhur me afatshmërin e ankesës së ankuesit,

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda A.nr.414/2021

Zyle Millaku GOJNOVCI
për Çështje
Procesmbajtëse

Malësore Gashi BAJRAKTARI
Malësore Gashi
Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit .
- Drejtorit të Përgjithshmen të Administratës Tatimore të Kosovës dhe
- Udhëheqësit të Personelit në Administratën Tatimore të Kosovës;
- Arkivit të KPMSHCK-së

